



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr. 4 Dt. 15.01.2015

PËR ANULLIMIN E LEJES "PËR PËRDORIM REZERVE UJORE"

SUBJEKTIT "PUKA GRUP" SHPK ME ADMINISTRATOR Z. BLERIM QARRI

Në mbështetje të Kreut VII, **nenit 50**, pikës 5, gërmës ç të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" autorizimet, lejet dhe konçesionet për përdorimin e ujrave mund të ndryshohen, të refuzohen, të pezullohen ose të shfuqizohen në bazë të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; **nenit 53**, pika 2, gërma b dhe c; dhe **nenit 54** pika 1 dhe pika 2 gërma ç; bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin - Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë :

VENDOSI:

1-Anullimin e lejes për përdorim të rezervës ujore nr.13 datë 05.09.2012, subjektit "PUKA GRUP", për shfrytëzim të burimit ujor Burimi I Peshve i cili ndodhet në jug lindje të qytetit të Pukës në shpatin malor që quhet Bjeshka e Terbunit, pasi ky subjekt nuk ka plotësuar kushtet për të cilin është dhënë leja, të pikës nr.1 të saj "Të respektohet qëllimi për të cilin jepet kjo leje" duke mos e përdorur ujin që nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj lejeje deri në muajin korrik 2014 për ambalazhimin e ujit, dhe të pikës 9 të saj, ku zotëruesi i lejes paguan tarifën për ujin e shfrytëzuar.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN- BUNË

SEKRETARI

Martin PLLUMBI



KRYETARI

Paulin RADOVANI

